



Në mbështetje të nenit 79 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 5 të Rregullores Nr. 13/2023 për Zëvendësimin apo Mungesën e Përkohshme nga puna e Nëpunësit Civil, si dhe në bazë të Rregullores Nr. 05/2022 Për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nepunesit Administrativ dhe Mbështetës, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, shpall:

KONKURS ME AFAT TË CAKTUAR

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale: Kërkon të punësojë në Departamentin e Inspektoratit.

Titulli i vendit të punës: Inspektor i Minerave-Gjeologji - 1(një) pozitë

Klasa / koeficienti: Inspektor/e / 7

Numri i referencës së vendit të punës: 001/06/2024

1. Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyrë vlerësimin e mineraleve të nxjerra nga minierat dhe guroret për kalkulimin e tatimeve,
- Hulumtojnë dhe raportojë KPMM-së në të gjitha aspektet e shfrytëzimit të burimeve minerare në regjion,
- Koordinojë punët në komunat dhe policinë në mbylljen e operimeve ilegale,
- Ofrojë industrisë informata mbi procedurat e lejeve për punë,
- : Ofrojë industrisë dhe komunave përvojë gjeologjike dhe ose /minerare,
- Identifikojë dhe definojnë nevojat dhe kërkesat për të dhëna gjeologjike dhe hidrologjike për të ndihmuar industrinë, autoritetet lokale, dhe departamentet e Qeverisë Qendrore (p.sh . KPMM-në, Ministrinë e Ambientit etj.) në punën e tyre,
- Mirëmbajtja e rregullt e shënimeve të inspektimeve për lëshimin e Licencave dhe Lejeve ne objekte minerare përpunuese dhe stabilimenteve ne miniera sipërfaqësore dhe nëntokësore,
- Koordinimi i inspektimeve me institucionet tjera,
- Detyra të tjera – në përputhje me ligjet dhe rregulloret – të cilat mund t’iu caktojë Kryeinspektori i Minerave kohë pas kohe sipas kërkesave

2. Shkollimi, aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushën e gjeologjisë. Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- Certifikata për programe Microsoft Office (Word, Excel etj).
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. Përvoja e punës, përveç vërtetimit të punësimit duhet dëshmuar edhe me pasqyrën e llogarisë nga Trusti ose Rregullores në fuqi.
- Të kenë njohuri të thelluara në aspektet metodologjike dhe aplikative dhe të jenë në gjendje ti përdorin këto njohuri për të interpretuar - kontrollua problemet e ndryshme te sektorit minerar në praktikë.
- Të njohë në përgjithësi dhe në thellësi fushat e Inxhinierisë Minerare, në të cilat të jenë në gjendje të identifikojnë, formulojnë dhe zgjidhin problemet duke përdorur metoda, teknika dhe pajisje bashkëkohore.

- Të ketë aftësi të nevojshme për kontrollimin - Inspektimin që gjendja dhe ndërtimi i pajisjeve dhe impianteve të xehetarisë në miniera nëntokësore dhe sipërfaqësore janë në përputhje me rregullat teknike.
- Të njohin përgjegjësitë e veta profesionale dhe etike
- Të fitojnë aftësi vendimmarrëse dhe komunikimi.
- Njohja e gjuhëve zyrtare në vend, përparësi njohja e gjuhës angleze.
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.

3. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

Kushtet e pjesëmarrje në rekrutim:

- Pranimi në shërbimin civil në pozitë e jokarrierës është i hapur për të gjithë.

Zbatimi i parimeve të punës:

- Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe parimet specifike të punës.

Kohëzgjatja e angazhimit: Me afat të caktuar, pozitë jo e karrierës

- Një (1) pozitë – deri në dymbëdhjetë (12) muaj

Paraqitja e aplikacioneve në adresën:

Komisioni i Pavarur për Minera dhe Minerale

Rr. Armend Daci Nr.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: icmm@kosovo-mining.org

Web: www.kosovo-mining.org

Data e njoftimit: 07.06.2024

Afati për aplikim: 10.06.2024-18.06.2024

Formulari për aplikim mund të shkarkohet në uebfaqen e KPMM-së:

Në linkun <http://kosovo-mining.org/>

Dokumentet që duhet të bashkangjiten aplikacionit:

Letër motivimi / CV

Dokumenti i identifikimit

Dëshmitë e kualifikimeve arsimore

Dëshmia mbi përvojën e punës

Letër-rekomandimet

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për informata plotësuese ju mund ta kontaktoni Zyrën e Personelit në:

Nr. i telefonit 038 240 252 203, ose mund të dërgoni email: icmm@kosovo-minig.org.